

PYETJE 1: Sa shtretër si kapacitet kemi në dispozicion për të akomoduar pacientët e infektuar me koronavirusin e ri dhe si do të sigurojmë personel mjekësor për t'i shërbyer atyre, sa kemi si numër dhe si është e organizuar?

PËRGJIGJE: Ka rreth 120 respirator në vend, numri më i madh - afër 90 janë në Shkup.

I gjithë personeli shëndetësor në të gjitha institucionet e shëndetit publik dhe spitalet private nëse mobilizohemi dhe i vë në dispozicion sipas planit tonë të veprimit në rast se është e nevojshme të punohet në një strukturë shëndetësore, ku do të jetë e nevojshme, si dhe institucionet private shëndetsore që kanë vënë në funksion kapacitetin e plotë që nga java e kaluar në dispozicion, përfshirë gati 70 shtretër intensiv, me respirator për këtë patologji.

Aktualisht kemi në dispozicion 185 shtretër. Klinika për sëmundje infektive dhe gjendje febrile në Shkup disponon me 110 shtretër. Në Departamentin e Sëmundjeve Infektive në Shtip, Gostivar dhe në Velesi kemi 75 shtretër. Me këto kapacitete, Klinika dhe hapsirat e parashikuara tani ofrojnë kujdes të mirë shëndetësor. Nëse është e nevojshme, planifikohet rritje e kapaciteteve sipas parametrave të parapërgatitur.

Kemi hartuar gjithashtu një plan për trajtimin e pacientëve me koronavirus në spitalin e përgjithshëm "8 Shtatori". Duke patur parasysh nevojën për një lloj tjetër trajtimi ndërhyrje - e pacientëve që janë të dyshimtë ose janë konfirmuar me koronavirus në mënyrë që të mbrohen hapsirat tjera, në spitalin "8 Shtatori" bëmë një vizitë me një komision special-drejtorë të disa klinikave dhe përfaqësues të Komisionit për sëmundje infektive.

Së bashku përcaktuam rrugën, rrjedhën e lëvizjes së pacientëve, pjesët e izolimit në pjesa e trijzhimit, ambulancat e pranimit, një sallë operative e veçantë, sallë e veçantë angeografike, një kabinet për eko-diagnostikimin dhe një departament krejtësisht i veçantë i cili aktualisht ka 22 shtretër dhe dy respiratorë.

Me këtë, praktikisht, sigurojmë pacientët nga gjithë shteti në kohën që ata diagnostikohen ose janë të dyshohen se kanë koronavirus dhe ka nevojë për ndonjë formë tjetër të operacionit ose një lloj tjetër i ndërhyrjes - të dërgohet direkt në spital "8 Shtatori", me qëllim të mos shkojë në institucione të tjera të shëndetit publik.

Klinikat mos mbajnë kolegjiomet e tyre të rregullta profesionale në mëngjes në mënyrë që të zvogëlohen kontakti mes kolegëve, koordinimi të bëhet përmes telefonit.

Masat e marra janë për të shmangur përhapjen e infeksionit dhe rritjen e shpejtë të numrit të pacientëve. Sistemi shëndetësor duhet të të jetë i gatshëm për të apsorbuar këtë goditje, gjë për të cilën ne jemi të gatshëm me kapacitet, pajisje, kuadër, i cili është i gatshëm të kyqen sipas nevojës. Të gjitha 200 anesteziologë, 400 infermierë, si shtesë përveç stafit që kemi tani,

Në pajtueshmërinë me zvogëlimin të programeve të tyre të rregullta, tani janë të gatshëm për t'u kyqur në trajtimin të kësaj sëmundje.

Ne duam ti mbrojmë punonjësit shëndetësorë, për fat të keq, në vendet e tjera ka shembuj në të cilat ata janë të prekur nga virusi, tani është me rëndësi që edhe ata të jenë të shëndetshëm sepse janë shtylla kryesore e këtij sistemi shëndetësor, ofruesit kryesorë të kujdesit shëndetësor.

PYETJE 2: Ekziston edhe mungesa e maskave mbrojtëse, vallë ka ndonjë mënyrë për të blerë apo burimet që janë në dispozicion janë të kufizuara?

PËRGJIGJE: Ministria e Shëndetësisë është e detyruar të mbulojë ekipet mjekësore nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Qendra e Shëndetit Publik, zona e karantinës në Dibër dhe Klinika për Sëmundje infektive dhe Gjendje Febrile. Në këtë drejtim, Qeveria u bëri thirrje të gjithë institucioneve tjerë për të prokuruar në kuadër të buxheteve të tyre. Ndërkohë, fabrikat e tekstilit tanimë ofrojnë kapacitet e tyre për të prodhimin e maskave.

PYETJE 3: OBSH-ja rekomandon që sa më shumë njerëz të testohen. Si të zbatohet ky rekomandim kur testet janë të kufizuara?

PËRGJIGJE: Nuk kemi teste të kufizuara, disponojmë dhe jem në gjendje të sigurojmë aq sa është e nevojshme.

PYETJE 4: Si bëhet ekzaminimi në Dibër dhe me çfarë teste?

PËRGJIGJE: Duke marrë materiale në përputhje me protokollin e vendosur për monitorimin epidemiologjik të kontaktit?

PYETJE 5: Sa teste për zbulimin e virusit Covid -9 kemi në vend?

PËRGJIGJE: Disponojmë një numër i mjaftueshëm testesh, rreth 1500. Kemi një njoftim për një dhurim prej 1000 dhe 1000 të tjerë prokurimi ynë.

PYETJE 6: A ekziston konkretisht ndonjë test me të cilin qytetarët mund vetë të testohen në shtëpi dhe të konstatojnë a janë të prekur nga virusi?

PËRGJIGJE: Nuk ekziston ndonjë test i tillë. Në treg hasim dhe janë janë të pranishëm gjithnjë e më shumë të ashtuquajturat të shpejtë të cilat janë serologjike, të cilat analizojnë antitruptat, megjithatë ato kanë të dhëna dhe studime dhe analiza që tregojnë se ato nuk janë me një shkallë të lartë të saktësisë. Nuk ka nevojë për askënd që të vete-testohet dhe të shpejtojë për mënyra alternative të testimit, është e mjaftueshme që qytetarët të jenë të vetëdijshëm, të raportojnë se ka nevojë për dhënave, historisë së sëmundjes, gjendjes, etj.

PYETJE 7: Pacientët të ri të diagnostikuar iu përgjigjën epidemiologëve se nuk kanë kontaktuar dhe që kanë qenë në izolim shtëpiak, ju merrni informata të tjera, gjegjësisht, që nuk është ashtu siç thonë ata?

PËRGJIGJE: Sondazhet epidemiologjike bëhen në mënyrë mjaft të detajuar, të dhënat e fituara janë të sakta

Pas shumë rasteve ku njerëzit nuk i respektojnë masat, është rreptësisht të sanksionuar. Qëllimi është të arrijmë deri tek kontaktet fillestare sepse ato janë më të rrezikshme, të cilët ka gjasa të mëdhaja të jenë infektuar dhe të përhapin infeksionin. Prej javës së ardhshme duam që të fillojmë me testime shpesh, për të zgjeruar pjesën e pacientëve asimptomatikë që janë në grupet më të rrezikshme.

PYETJE 8: Personat të infektuar rishtas nga Dibra kanë ndonjë lidhje me personat e mëparshëm ose kanë udhëtuar prej diku?

PËRGJIGJE: Të gjithë personat të diagnostikuar në Dibër deri më tani kanë lidhje me grupin prej 10-11 personave fillimisht të infektuar, dhe pas fillimisht të infektuarve 9 që erdhën

Qarte bëhet fjalë për një komunikim intensiv, kontakte me njerëz.

PYETJE 9: Sa është kapaciteti i shëndetit publik? Dhe a do të futen klinika të tjera

ne funksion për këtë qëllim?

PËRGJIGJE: Ne kemi hartuar gjithashtu një plan për trajtimin e pacientëve me koronavirus në Spitalin e Përgjithshëm të Qytetit "8 Shtatori". Duke pasur parasysh që ekziston nevoja për një lloj tjetër të ndërhyrjes mjekësore - pacientëve që janë të dyshimtë ose të konfirmuar me koronavirus, me qëllim të ruajtjes së kapaciteteve të tjera, në spitalin "8 Shtatori" bëmë vizitë me një komision të veçantë - drejtorët e disa klinikave dhe përfaqësuesit e Komisionit për Sëmundje Infektive.. Së bashku në vend u përcaktua rruga, rrjedha e lëvizjes së pacientëve, seksionet për izolim në zonën e traqeteve, ambulancat e pranimit, një sallë të veçantë operative, një sallë e veçantë angiografike, një kabinet i veçantë për eko diagnostikimin e dhe një repart plotësisht i veçantë i cili për momentin ka 22 shtretër dhe dy aparate respiratore. Me këtë, praktikisht, ne mundësuam të gjithë pacientët në momentin që ata do të diagnostikohen ose dyshohet se janë të prekur nga koronavirusi dhe kanë nevojë për ndonjë intervenim hirurgjik ose një lloj tjetër i ndërhyrjes - direkt të dërgohen në spital "8 Shtator", me qëllim të mos shkojnë në institucione tjera të shëndetit publik.

PYETJE 10: Pse pasagjerët që vijnë me aeroplan vendosen në vetëizolim dhe ata

çfarë vijnë nga vendkalimet kufitare vihen në karantinë grupor? Çfarë është dallimi?

PËRGJIGJE: Për arsye se prsinim dhe ende jemi duke pritur një numër më të madh të njerëzve që nuk mund të kanalizoheshin në mënyrë tjetër përpos kësaj. Në aeroport është i vendosur infrastruktura e kamerave, epidemiologët dhe kjo nuk ishte e mundur të zbatohet në vendkalimet tjera kufitare , përveq në Devebair dhe të gjithë që presim do të drejtohen andej.

PYETJE 11: Personat me multiple sklerozë të cilët marrin terapi që ndikon në zvogëlimin e imunitetit, kanë frikë në qoftë se bijnë në kontakt me një person të infektuar, më lehtë mund të infektohen me koronavirus, çfarë me këto grup pacientësh?

PËRGJIGJE: Lista e diagnozave thotë qartë se kushdo që vuan nga një gjendje imunomompromise, dhe kjo është një gjendje e tillë që është e liruar nga puna. Ka njerëz që shumë mire funksionojnë edhe pa terapi, ndërsa kanë diagnozë të tillë.